

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**«Infotelecom-Albsolar 4» shpk**

**Tiranë, më 08.08.2024**

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

## TABELA E LENEDES

<b>DISPOZITA TE PERGJITHSHME</b> .....	<b>3</b>
Forma ligjore dhe emri i shoqerise .....	3
Ortakët e shoqërisë dhe kapitali i regjistruar i saj.....	4
Kohëzgjatja .....	4
Selia kryesore.....	<b>Hata! Yer işareti tanımlanmamış.</b>
Objekti i aktivitetit .....	5
<b>ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË</b> .....	<b>5</b>
Organet drejtuese .....	5
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kompetencat.....	5
Vendimet e rëndësishme .....	6
E drejta e votes dhe kuorumi .....	6
Njoftimi i mbledhjeve; Heqja dore .....	7
Prezenca; Mbledhjet elektronike.....	7
Proçesverbalet e mbledhjes së Asamblesë .....	8
Emerimi i Administratorit .....	<b>Hata! Yer işareti tanımlanmamış.</b>
Kompetencat e pergjithshme te Administratorit .....	8
Pergjegjesite e Administratorit.....	9
Kufizimet e kompetencave te Administratorit .....	9
Shkarkimi i punonjesve; Doreheqja.....	10
Shkembimi i informacionit me Ortaket .....	11
Politikat e Administrimit .....	11
<b>KONTRIBUTET NE KAPITAL; SHPERNDARJA; BUXHETI</b> .....	<b>12</b>
Pagesa e kontributeve te kapitalit te rena dakord.....	12
Shpendarja fitimeve .....	12
<b>Arbeni</b> .....	12
<b>Margilaj</b> .....	

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

Planet e biznesit .....	12
<b>KONTABILITETI; CESHTJE TATIMORE</b> .....	<b>13</b>
Viti Financiar .....	13
Librat e kontabilitet.....	13
Raportet periodike.....	13
Regjistrat .....	14
Auditet.....	15
<b>TRANSFERIMI I KUOTAVE</b> .....	<b>15</b>
Kushtet dhe procedurat per transferimin e kuotave .....	15
<b>PRISHJA, SHNDËRRIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË</b> .....	<b>15</b>
Mbyllja.....	16
Shndërrimi i shoqërisë .....	16
<b>DISPOZITA TE FUNDIT</b> .....	<b>16</b>
Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve .....	16
Hyrja në fuqi .....	16

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni I

#### Forma ligjore dhe emri i shoqerise

- 1.1 Shoqeria ka emertimin “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k (ne vijim referuar si “Shoqeria”). Shoqeria gjithashtu mund te kryje aktivitet sipas cdo emri tjetër per te cilin bien dakord ortaket.
- 1.2 Shoqëria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit të përcaktuar në këtë statut, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe marrëveshjeve të ortakëve. Ne rast se dispozitat e ketij statuti bien ne kundërshtim me dispozitat e Marreveshjeve te Ortakeve, keto te fundit do te kene perparesi.
- 1.3 Shoqeria eshte e organizuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” (ne vijim “Ligji i shoqerive tregtare”) dhe aktet e brendshme te shoqerise.

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:16:35 +0200

## Neni 2

### Ortakët e shoqërisë dhe kapitali i regjistruar i saj

- 2.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100 (njëqind) ALL dhe ndahet në 3 (tre) kuota, të cilat zotërohen nga ortakët e saj.
- 2.2 Ortakët e Shoqërisë janë:
1. **Solar Park Gjoricë SHPK**, një shoqëri regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: Godina Park Gate, Rruga Elbasanit, kati i parë, Tiranë, Shqipëri, me NUIS M32313042A, e cila zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
  2. **INFO-Telecom SHPK**, një shoqëri regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: Godina Park Gate, Rruga Elbasanit, kati i parë, Tiranë, Shqipëri, me NUIS K92402002P, e cila zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 20% (njëzet përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
  3. **"Adame Mühendislik Enerji SAN. TİC. LTD. ŞTİ."** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila regjistruar dhe që funksionon në bazë të legjisllacionit të Republikës së Turqisë, me seli qendrore në Cemalpasa Mah. Bahar Cad. No 35 Seyhan Adana, me numër të identifikimit të subjektit 0007 116 193100001 (Mersis Number) dhe Nr. të Regjistrimit Tregtar 80653, e cila zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 20% (njëzet përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;

## Neni 3

### Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.
- 3.2 Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

## Neni 4

### Seliakryesore

- 4.1 Selia kryesore e veprimtarisë së shoqërisë do të jete në Tiranë, në adresën: *Rruga "Faik Konica" nr. 1, Pallati Kuq*. Shoqëria mund të ketë zyrë të tjera në vende të tjera sikunder mund të vendoset nga Ortakët here pas here.
- 4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyrë përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.
- 4.3 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

## Neni 5

### Objekti i aktivitetit

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetet tregëtar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: “Veprimtari në fushën e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, sic është prodhimi i energjisë nga burime fotovoltaike, ruajtja dhe tregtimi i kësaj energjie brenda dhe jashtë vendit. Kryerja e cdo aktiviteti të lejuar në Republikën e Shqipërisë, i cili është ose jo në funksion të objektit të kësaj shoqërie”.
- Angazhimin në secilin dhe në cdo aktivitet dhe transaksion të nevojshëm ose të pershtatshëm për të operuar dhe kryer biznesin.
  - Çdo veprimtari tjetër e lejuar nga legjislacioni në fuqi.
- 5.2 Shoqëria ka të gjitha kompetencat e nevojshme, të duhura ose të pershtatshme për zhvillimin e aktivitetit të saj në përputhje me, dhe sipas termave dhe kushteve të këtij Statuti. Shoqëria nuk do të anagazhohet në ndonjë biznes ose aktivitet që është jashtë objektit të saj, dhe të ndryshëm nga zhvillimi i biznesit.

## Kreu II

### ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

## Neni 6

### Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë janë: -  
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve; -  
Administratori.

## Neni 7

### Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kompetencat

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve (në vijim referuar si “Asambleja”) gëzon çdo kompetencë të parashikuar në nenin 81 të Ligjit për shoqëritë tregëtare dhe vendos për çështjet si vijon:
- Marrjen e kredive;
  - Caktimin e pagave të administratorëve dhe të punonjësve;
  - Miratimin e rregulloreve,
  - Shitjen dhe blerjen e aseteve të paluajtshme;
  - Lenien peng apo hipoteke të aseteve të shoqërisë;
  - Dhënie me qira të aseteve të shoqërisë;
  - Caktimin e perfaqësuesve në çështje gjyqësore; dhe

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

h. Cdo kompetencë tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

7.2 Asambleja, veç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat në lidhje me administrimin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që ky Statut ia njeh dhe ia ngarkon Administratorit.

## Neni 8

### Vendimet e rëndësishme

8.1 Vendimet e mëposhtme do të jenë nën juridiksionin ekskluziv të Asamblese dhe do të merren me unanimitet nga ortaket:

- a. Ndryshimi i të drejtave dhe detyrimeve të Ortakeve në shoqëri;
- b. Rritja dhe zvogelimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë;

8.2. Vendimet e mëposhtme do të merren ekskluzivisht nga Asambleja me shumicë të cilesuar prej  $\frac{3}{4}$  të votave të ortakeve:

- a. Dhenia hua ndaj Ortakeve;
- b. Cdo lloj shitje, caktimi ose transferimi i aktiviteteve aktuale të shoqërisë tek një pale e tretë;
- c. Bashkimi, blerja, perthithja, mbyllja ose likuidimi i shoqërisë;
- d. Ndryshimi i formes ligjore të shoqërisë (p.sh shndërrimi në një shoqëri anonime); dhe
- e. Shpërndarja e fitimeve/dividenteve.

## Neni 9

### E drejta e votes dhe kuorumi

9.1 Asambleja do të thirret e do të mbahet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Shoqërive Tregtare dhe akteve të brendshme të shoqërisë.

9.2 E drejta e votes në Asamble do të jetë në proporcion me zoterimin e kuotave nga secili Ortak. Secili prej Ortakeve ka të drejtë të propozojë çështje që do të përfshihen në rendin e ditës së Asamblese.

9.3 Asnjë vendim i vetëm i Asamblese nuk mund të behet pa kuorumin e kërkuar. Në mënyrë që të arrihet kuorumi i kërkuar, duhet të jenë të pranishëm ortaket që përfaqësojnë të paktën 51% të votave të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

9.4 Në rast se mbledhja e Asamblese nuk arrin kuorumin për të marrë vendim, atëherë, brenda 8 (tete) ditësh do të mbahet një mbledhje e re me të njëjten rend dite dhe nëse në këtë rast Asambleja do të marrë vendime të vlefshme ligjrisht pa patur nevojën e arritjes së kuorunit të vecantë, përveç se për vendimet që do të merren me unanimitet nga ortaket sikundër parashikohet në këtë statut.

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:16:35 +02'00'

## Neni 10

### Njoftimi i mbledhjeve; Heqja dore

- 10.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
- 10.2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 10.3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 10.4. Te gjitha njoftimet, kërkesat, padite, apo komunikimet e tjera do të behen në formë të shkruar dhe do t'iu jepen apo nisen (dhe do të konsiderohen sikur janë dërguar në mënyrën e duhur ose kryer në momentin e marrjes) tek Ortaket perkates në adresat e mëposhtme:

- **Per Solar Park Gjoricë Shpk**

Person kontakti: Z. Arben Margilaj

E-mail: arben.margila@infotelecom.al

- **Per INFO -Telecom shpk**

Znj. Aida Maho

E-mail: aida.maho@infotelecom.al

- **Per Adame Mühendislik Enerji SAN. TİC. LTD. ŞTİ.**

Person kontakti: Mr. Özgür Karamanoğlu & Mr. Emre ÜÇKARDEŞ

E-mail: o.karamanoglu@adame.com.tr & emre.uckardes@adame.com.tr

## Neni 11

### Prezenca; Mbledhjet elektronike

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

- 11.1 Asambleja mund të mbahet me anë të përdorimit të konferencës telefonike, me video ose pajisje komunikimi të ngjashme për sa kohë që të gjithë ortakët të cilët marrin pjesë në këtë mbledhje mund të identifikohen njëri tjetrin në kohën e kësaj mbledhjeje. Pjesëmarrja në një mbledhje të ortakëve me anë të pajisjeve që përdorin komunikimin elektronik në përputhje me fjalën pararendëse do të përbejnë prezencën, në person, në këtë mbledhje.
- 11.2 Asambleja mund të marrë vendimet duke qarkulluar vendimin me shkrim dhe nënshkrimin e tij nga të gjithë ortakët. Miratimi i ortakëve mund të dërgohet me email, dhe do të konsiderohet i vlefshëm dhe i duhur nëse dërgohet në një adresë email të administratorëve e cila është e vlefshme dhe e disponueshme.

## Neni 12

### Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë

- 12.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendit të mbledhjes, rendin e ditës emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit. Kryesuesi i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes.
- 12.2 Procesverbalit i bashkëlidhet dhe akti i thirrjes së Asamblesë.
- 12.3 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga të dy ortakët dhe sekretari i mbledhjes.

## Neni 13

### Emerimi Administratorit

- 13.1 Shoqëria do të administrohet në aktivitetin e përditshëm nga një Administrator (në vijim referuar si "Administratori"). Administratori do të emërohet për një afat tre vjeçar të rinovueshëm nga Asambleja. Administratori do t'i kushtojë të gjithë kohën e punës dhe përpjekjet e tij ose saj ndaj aktivitetit dhe punëve të Shoqërisë.
- 13.2 Drejtuesit e tjerë të Shoqërisë (përveç personit përgjegjës për financat, në vijim "Financieri" i cili do të emërohet nga Asambleja) do të emërohen nga Administratori me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

## Neni 14

### Kompetencat e përgjithshme të Administratorit

- 14.1 Administratori do të raportojë në mënyrë direkte dhe ekskluzive të Ortakët dhe do të zbatojë të gjithë urdhrat dhe vendimet e Ortakëve. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet në emër dhe për llogari të Shoqërisë në përputhje me këtë Statut, planin e biznesit, buxhetin dhe politikën dhe procedurat e përcaktuara nga Ortakët. Të gjithë

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +0200



punemarresit e Shoqerise do te raportojne te Administratori ose te personat e autorizuar prej tij.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

15.1 Administratori do te administroje punet e perditshme te aktivitetit te Shoqerise brenda Shqiperise ne perputhje me kete statut, planin e biznesit, buxhetin, politikat dhe procedurat e percaktuara nga ortaket; me perjashtim te rastit kur percaktohet ndryshe ne kete statut, detyrat e meposhtme do te jene pergjegjesi ekskluzive e Administratorit:

- a. Drejtimi i aktiviteve te perditshme te Shoqerise;
- b. Kryerja e administrimit te perditshem te Shoqerise;
- c. Perfaqesimi i Shoqerise;
- d. T'i jape Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve raporte mujore ne ditet e 5-te te muajit per cdo muaj paraardhes (ne nje linje me planin e biznesit te miratuar), ne perputhje me modelin qe do te jepet nga "INFO-Telecom" shpk;
- e. Te siguroje se Shoqeria po zbaton te gjitha legjisalcionin shqiptar ne fuqi gjate aktivitetit te saj;
- f. Monitorimi dhe kontrolli i te gjitha shpenzimeve;
- g. Zhvillimin/rritjen e aktivitetit te Shoqerise ne territorin e Shqiperise;
- h. Me miratimin e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, punesimin e punemarresve te rinj (me perjashtim te financierit) dhe monitorimi i punemarresve ekzistues si dhe verifikimi konstant i performances/kompetencave te punemarresve;
- i. Raportimi i kushteve dhe ndryshimeve te tregut tek Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

## Neni 16

### Kufizimet e kompetencave te Administratorit

16.1 Administratori nuk mund te kryeje aktivitetet e meposhtme pa miratimin paraprak te Asamblese:

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

Aktivitetet te cilat jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese;

- b. Përfundimin e çdo marrëveshje, kontratave ose transaksioneve të cilat janë jashtë fushës normale të biznesit apo jashtë biznesit bazë të shoqërisë;
- c. Barresimi i operacioneve të shoqërisë, fondeve të saj, asetëve ose pretendimeve jashtë fushës normale të biznesit;
- d. Të gjithë investimet kapitale ose disponimi i asetëve të cilat nuk janë miratuar në buxhetin dhe në planin e biznesit vjetor;
- e. Ndryshimi i strukturës organizative të shoqërisë;
- f. Përcaktimi ose ndryshimi i planeve në lidhje me ndarjen e fitimit, bonuseve ose nxitjeve të tjera të çdo natyre për punëmarresit e shoqërisë, kur këto bonuse tejkalojnë 30% të pages vjetore të punëmarresit;
- g. Të marrë kredi/hua në institucionet bankare apo jo bankare apo qira financiare, ku Shoqëria të jetë në cilësinë e qiramarrësit;
- h. Miratimi i dhenies së kredive për ortakët ose paleve të treta,
- i. Miratimi i blerjes ose transferimi i pasurive të paluajtshme dhe i kontratave të qirase;
- j. Dhenia e garancive, sigurimi ose kompensimi për përmbushjen e detyrimeve ose marrjen për sipër të angazhimeve të paleve të treta;
- k. Emerimi dhe shkarkimi i financierit.


## Neni 17

### Shkarkimi i punonjësve; Doreheqja

- 17.1 Çdo punëmarres i Shoqërisë, përfshirë edhe Administratorin, mund të shkarkohet nga Asambleja në çdo kohë me ose pa arsye sa herë që në gjykimin e saj do të shërbejë apo do të jetë në interesin me të mirë të Shoqërisë, megjithatë, (i) Administratori nuk mund të shkarkohet pa votën e Ortakut të Përve;
- 17.2 Punëmarresit e emëruar nga Administratori mund të shkarkohen nga ata ose detyrat e tyre mund të ndryshohen në mënyrë substanciale nga ata, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 17.3 Administratori mund të heqë dorë nga pozicioni i tij duke i dhënë ortakëve një njoftim me shkrim. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në atë njoftim, doreheqja hyn në fuqi pas marrjes së këtij njoftimi nga ana e Ortakëve, dhe pranimit të doreheqjes nuk është i nevojshëm për ta bërë atë efektive. Deri në zëvendësimin e Administratorit i cili është shkarkuar ose jep doreheqjen, Ortakët kanë të drejtë të caktojnë një zëvendësues të perkohshëm, ose për të

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

ushtruar perkohesisht detyren e Administratorit, deri në emerimin e nje Administratori te ri nga ana e Asamblese sipas percaktimeve te ketij statuti.

## Neni 18

### Shkembimi i informacionit me Ortaket

- 18.1 Administratori do t'i jape secilit prej ortakeve te gjithë informacionin ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise i cili kerkohet ne menyre te arsyeshme nga keta Ortake, perfshire marredheniet me pale te treta dhe shoqerite e lidhura, ne menyre qe te sigurojne ne menyre te arsyeshme kete Ortak se veprimet e Administratorit do te jene ne interesin me te mire te Shoqerise dhe se nuk do te vene ne disavantazh te nje ortaku kundrejt tjetrit.
- 18.2 Me miratimin e buxhetit operacional vjetor nga ortaket, secili ortak do te vendose sa shpesh ky ortak dhe Administratori duhet te takohen per te diskutuar progresin drejt objektivave operationale te Shoqerise.
- 18.3 Administratori do t'i jape secilit ortak informacion te plote ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne menyre qe rezultatet financiare te Shoqerise ne cdo moment te jene te parashikueshme nga secili ortak.
- 18.4 Shoqeria do te adoptoje formatin, shpeshtesine dhe kerkesat e "Solar Park Gjoricë" shpk, per raportimet e parashikuara ne kete nen.

## Neni 19

### Politikat e Administrimit

- 19.1 Administratori, punemarresit me pozicione drejtuese si dhe te punesuarit e tjere te Shoqerise do te pergatisin dhe do te implementojne politikat e administrimit sipas dhe ne perputhje me politikat e pergjithshme dhe programet e miratuara te Asamblese, planit te biznesit dhe buxhetit.
- 19.2 Pervec se kur kerkohet ndryshe nga Ortaket, Administratori do te marre pjese ne Mbledhjet e asamblese.

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'



### Kreu III

## KONTRIBUTET NE KAPITAL; SHPERNDARJA; BUXHETI

### Neni 20

#### Pagesa e kontributeve te kapitalit te rena dakord

- 20.1 Secili nga Ortaket do te jape kapital per Shoqerine, ne nje vlere qe duhet te jete e mjaftueshme per te perballuar shpenzimet e percaktuara ne buxhet, sipas rastit, duke kryer dhe kontribute "cash" shtese ne kapitalin e Shoqerise, ne perpjestim me perqindjen e interesit qe keta ortake zoterojne ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise. Secili prej ortakeve do te kryeje kete kontribut brenda (30) diteve pune, pas dates kur ortaket do te kene vendosur se Shoqeria ka nevojë per kontribute "cash" shtese.
- 20.2 Menyra e kryerjes se pagesave, njoftimet per pagesat, rastet e mospermbushjes se detyrimit per pagesa te kapitalit, pasojat e ketyre mospermbushjeve si dhe te drejtat dhe pergjegjesite e ortakeve ne lidhje me sa me sipër, do te jene sipas percaktimeve te Marreveshjes se Ortakeve.

### Neni 21

#### Shperndarja fitimeve

- 21.1 Shperndarja e fitimeve te Shoqerise, ortakeve te saj, behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe parashikimeve te Marreveshjes se Ortakeve.
- 21.2. Asambleja e ortakëve mund të vendosë me vendim shpërndarjen e fitimeve mes ortakëve në një mënyrë të ndryshme nga pjesëmarrja e tyre në kapitalin e shoqërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe parashikimeve te Marreveshjes se Ortakeve.

### Neni 22

#### Buxheti

Buxheti i Shoqerise do te pregatitet, miratohet dhe zbatohet ne perputhje me parashikimet e Marreveshjes se Ortakeve.

### Neni 23

#### Planet e biznesit

Plani i biznesit te Shoqerise do te pregatitet, miratohet dhe zbatohet, ne perputhje me parashikimet e Marreveshjes se Ortakeve.

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:16:35 +02'00'

## Kreu IV

### KONTABILITETI; CESHTJE TATIMORE

#### Neni 24

##### Viti Financiar

Llogaritja e shpenzimeve, të ardhurave dhe fitimit për Shoqërinë bëhet për çdo vit financiar. Çdo vit financiar fillon më datën 01 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### Neni 25

##### Librat e kontabilitet

Shoqëria do të mbajë librat kontabel të aktivitetit të shoqërise, në mënyrë të plotë dhe të duhur, në seline qendrore të saj si dhe në çdo vend tjetër që do të vendoset nga Asambleja apo kërkohej nga legjislacioni. Këto libra do të përfshijnë, por pa u kufizuar në, të gjithë të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet e shoqërise.

#### Neni 26

##### Raportet periodike

26.1 Shoqëria do të përgatitë dhe dërgojë tek secili ortak, sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga "Solar Park Gjoricë", sa më poshtë:

- a. Një buxhet vjetor dhe një plan biznesi parashikues tre vjeçar të rishikuar (i përditësuar çdo vit) për Shoqërinë jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë para fillimit të çdo viti financiar;
- b. Llogaritë e audituara të shoqërise nga momenti që behen të disponueshme, por në çdo rast jo më vonë se 4 muaj nga data e fundit të çdo Viti Financiar;
- c. Llogaritë manaxheriale mujore të paaudituar të shoqërise, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas fundit të çdo muaji;

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

d. Llogarite manaxheriale tremujore te paauditua te shoqerise, brenda 30 (tridhjete) diteve pas fundit te cdo tremujori;

26.2 Shoqeria do te mbylle librat kontabel pas mbylljes se cdo muaji ne cdo vit financiar. Cdo raport mujor do te perfshije gjithashtu nje buxhet qe parashikon fitimet dhe humbjet dhe bilancin per shoqerine. Shoqeria do te paraqese keto raporte dhe cdo raport shtese qe mund te kerkohet ne menyre te arsyeshme si dhe kur kerkohet per te permbushur secilen prej praktikave raportuese financiare te secilit Ortak rast pas rasti, gjithnje duke u pershtatur ne varesi te ngarkeses se punes se stafit te shoqerise.

26.3 Ortaket do te bashkepunojne plotesisht me njeri-tjetrin dhe t'i paraqesin njeri-tjetrit ne baze te kerkeses, te gjithhe informacionin financiar te nevojshem dhe analizen perkatese te llogarive lidhur me interes respektive ne shoqeri.

26.4 Nese Administratoret e shoqerise nuk permbushin detyrimet e tyre sipas ketij neni brenda 30 (tridhjete) diteve nga dita e percaktuar ose ne dy ose me shume raste te njepasnjeshme, ortaku i interesuar mund te emeruje eksperte kontabel, te paraqiten ne zyrat e shoqerise, te hetoje dhe te pergatisin dokumentat. Shoqeria dhe nepunesit e shoqerise duhet te bashkepunojne me ekspertet kontabel dhe Shoqeria duhet te paguaje tarifat e eksperteve kontabel dhe shpenzimet per ta, pervec rastit kur mospermbushja ka ardhur per shkak te Administratorit te emeruar nga ortaku qe ka caktuar ekspertin kontable si me lart; ne kete rast tarifat dhe shpenzimet e ekspertit do te paguhet nga ortaku i interesuar.

#### Neni 27

##### Regjistrat

27.1 Shoqeria do te mbaje ne seline qendrore te saj, libra dhe regjistra ne menyren e duhur sikunder kerkohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi. Pervec sa me siper, shoqeria do te mbaje ne seline qendrore te saj sa me poshte vijon:

- a. Nje liste aktuale te emrit te plote dhe te adreses se fundit te bere me dije nga secili ortak;
- b. Nje kopje te ketij statuti dhe te Marreveshjes se Ortakeve dhe te gjitha ndryshimeve te tyre;
- c. Kopje te deklaratave dhe raporteve tatimore te shoqerise, nese ka, te 3(tre) viteve financiare te fundit;
- d. Kopje te pasqyrave financiare, nese ka, te shoqerise te 5 (pese) viteve financiare te fundit; dhe
- e. Cdo dokument tjeter ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise sikunder mund te kerkohet ne menyre te arsyeshme rast pas rasti me vendim te Asamblese.

27.2 Pervecse kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, shoqeria do t'i jape cdo ortaku, me kerkese te ketij te fundit, informacion mbi Shoqerine, shitjet e saj, faturat, pagesat, cdo informacion kontabel dhe regjistrimet si dhe te gjitha aktivitetet e shoqerise. Cdo ortak dhe perfaqesuesit e tij do te jene te lire te diskutojne mbi veprimtarine dhe aktivitetin e Shoqerise me

Arben  
Margilaj

Digitally Signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +02'00'

Administratoret dhe t'iu kerkojne ketyre te fundit qe t'iu japin kopje te te gjithe librave, regjistrimeve dhe infomacione te tjera ne lidhje me veprimtarine dhe biznesin e shoqerise.

#### Neni 28

##### **Auditet**

Ortaket bien dakord te caktojne auditite te njohur financiare qe te kryejne auditimin vjetor te pasqyrave financiare te shoqerise.

#### Kreu V

### **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

#### Neni 29

##### **Kushtet dhe procedurat per transferimin e kuotave**

29.1. Transferimi i kuotave te Ortakeve do te kryhet vetem ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne Marreveshjen e Ortakeve.

29.2. Ortakët nuk mund të transferojnë kuotat përpara 3 (tre) viteve nga data e energjizimit të projektit "Solar Park Gjorice" shpk.

29.3. Për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) vjeçare nga viti i tretë (3-të) i Datës së Operimit Tregtar (energizimit), çdo transferim i kuotave, kryhet vetëm me miratimin paraprak me shkrim të Ministrise së Infrastrukturës dhe Energjisë.

29.4 Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 30.2. ortakët mund të transferojnë lirisht kuotat sipas marrëveshjes mes ortakëve.

29.5 Në ccdo rast ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

#### Kreu VI

### **PRISHJA, SHNDËRRIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:35 +0200

#### Neni 30



## Mbyllja

Shoqëria do të mbyllet dhe aktiviteti i saj do të përfundojë, në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Ortakeve.

## Neni 31

### Shndërrimi i shoqërisë

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore sipas legjislacionit në fuqi, këtij statuti dhe Marrëveshjes së Ortakeve.

## Kreu VII

### DISPOZITA TE FUNDIT

## Neni 32

### Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve

Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 33

### Hyrjanëfuqi

Ky Statut është i hartuar në katër kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe depozitimin e tij pranë Regjistrimit Tregtar.

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:16:35 +02'00'



**“Infotelecom-Albsolar 4” shpk Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

**1. Solar Park Gjoricë Shpk**

Z. Arben Margilaj – CEO

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:49:15 +02'00'



**2. INFO -Telecom shpk**

Zj. Ada Osmanaj – CEO

Ada Osmanaj



**3. Adame Mühendislik Enerji SAN. TİC. LTD. ŞTİ.**

Z. Emre ÜÇKARDEŞ – Perfaqesues me Prokure te Posaçme

**ADAME MÜHENDİSLİK/ENERJİ**

İNSAAT SAN VE TİC LTD. ŞTİ

Cemalpaşa Mah. Bahar Cad. No:35


Seyhanı ADANA

Seyhan VD. 007 116 1931

Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:56:35 +02'00'

**Shoqëria “Infotelecom Albsolar 4” shpk**  
**Specimeni i nënshkrimit të Administratorit**

Të dhënat e Administratorit	Specimeni i nënshkrimit
<p><b>Z. Gentian Jahja</b> Shtetas Shqipar Lindur me: 23.08.1970 Nr.Personal i ID: <b>H008230430</b> Adresa: Tiranë</p>	<p>Gentian Jahja. </p>

**STATUTE OF  
LIMITED LIABILITY COMPANY**

**“Infotelecom – Albsolar 4” Ltd**

**Tirana, on 08.08.2024**



Arben  
Margilaj

Digitally signed by  
Arben Margilaj  
Date: 2024.08.21  
12:36:34 +02'00'



**TABLE OF CONTENT**

**GENERAL PROVISIONS..... 4**

    Juridical regime and the name of the Company ..... 4

    Charter capital –shares ..... 4

    Term ..... 5

    Principal place of business ..... 5

    Object of the activity ..... 5

**BODIES OF THE COMPANY AND THE ADMINISTRATION ..... 6**

    The Bodies of the Company ..... 6

    The General Assembly ..... 6

    Exclusive rights of Assembly ..... 8

    Method of convening and notifications ..... 8

    Participation at the meeting of the General Assembly ..... 8

    Minutes of the General Assembly Meeting..... 9

    The Administrator ..... 9

    General powers of Chief Executive Officer ..... 9

    Responsibilities of the CEO ..... 10

    Restrictions on the powers of CEO ..... 10

    The appointment and the dismissal of the Administrator ..... 11

    Exchange of Information with Shareholders ..... 12

    Management policies..... 12

**CAPITAL CONTRIBUTIONS; DISTRIBUTIONS; BUDGET ..... 12**

    Drawdown and payment of agreed capital contributions ..... 12

